



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 231, Datë 12.09.2022

MBI

SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “OST” SH.A. PËR TRANSFERIMIN E ASETVEVE TË INVESTIMIT TË KRYER NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “SUPPLY AND INSTALATION OF TRANSMISSION METER/DATA CENTER” NGA OST SH.A. TEK OSHEE GROUP SH.A.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1528 prot., datë 08.09.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “OST” sh.a. për miratimin e transferimit të asetëve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and instalation of transmission meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE GROUP sh.a.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 174, datë 07.07.2022, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për miratimin e transferimit të asetëve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center”, nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.
- Në vijim të këtij vendimi ERE i’u dejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e bordit të ERE-s nr. 174/2022 si dhe duke i kërkuar depozitimin e listës së detajuar të asetëve që do të transferohen dhe përcjelljen e një informacioni shtesë në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, që do të jenë në funksion të realizimit të transferimit të Asetëve të Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. Lidhur me këtë transferim, shoqëria duhet të sqaronte nëse këto investime janë të OST sh.a. dhe do t’i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. apo janë vetëm për efekt të vlerave të investimeve, që të njihen si kosto e OSSH sh.a.
- Meqënëse dokumentacioni i protokolluar në ERE nga OST sh.a. me shkresën nr. 944/2, është depozituar më datë 06.09.2022 dhe duhet të analizohet nga ERE në kuptim edhe të bazës

ligjore në lidhje me këtë transferim për të dalë me një vendim përfundimtar, vlerësohet e nevojshme shtyrja e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e OST sh.a. për transferimin e aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply And Instalation Of Transmission Meter/Data Center” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

- “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, në nenin 10 “Afati i shqyrtimit të kërkesës”, në pikën 1 të tij parashikon se:

1. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e aseteve, nëse i liçensuari ka plotësuar tërësisht informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, do të bëhet brenda 45 ditëve pune nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.

- Në mbështetje të nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” me qëllim sqarimin e konstatimeve të mësipërme, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë kalendarike e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center”, nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center”, nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI